

URDHËR
Nr. 358, datë 8.4.2019

PËR DELEGIMIN E KOMPETENCAVE

Në mbështetje të pikës 4, të nenit 102, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, të ligjit nr. 152/2015, datë 21.12.2015 “Për shërbimin e mbrojtjes nga zjarri dhe shpëtimin”, të ligjit nr. 9000, datë 30.1.2003 “Për organizimin dhe funksionimin e Këshillit të Ministrave”, si dhe të nenit 29, të ligjit nr. 44/2015 “Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë”,

URDHËROJ:

1. Delegimin e kompetencave të titullarit të drejtorit të përgjithshëm të MZSH-së, Sekretarit të Përgjithshëm të Ministrisë së Brendshme, z. Dritan Palnikaj, për këto çështje:

- a) trajtimin dhe ndjekjen e procedurave për fitimin e gradave të nivelit të mesëm dhe bazë;
- b) nënshkrimin për dhënien e gradave të nivelit të mesëm dhe bazë bazuar në aktin e vlerësimit të komisionit të gradave;
- c) trajtimin dhe nënshkrimin e ankesave që kanë të bëjnë me çështjet e trajtuara në gerrat “a” dhe “b”, të kësaj pike.

2. Kompetencat e titullarit të drejtorit të përgjithshëm të MZSH-së, për çështjet e përcaktuara në gerrat “a”, “b” dhe “c”, të pikës 1 të këtij urdhri, do të ushtrohen nga data 3.4.2019 deri në emërimin e drejtorit të përgjithshëm të MZSH-së.

3. Për zbatimin e këtij urdhri ngarkohet Sekretari i Përgjithshëm, z. Dritan Palnikaj.

Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

MINISTËR I BRENDSHËM
Sandër Lleshaj